



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo  
Viti/na

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

30-06-2022			
Nr. i organit Org. brej	Numri (Eto)	Shifra Prillog	Vlera Vendime
01-110/05-660			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), dhe neni 40, paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022, merr këtë:

## VENDIM

### Për kornizën afatmesme buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë, 2023-2025

#### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë MIRATON vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë, 2023-2025 “, Duke u bazuar në QARKOREN Buxhetore 2023/01 të datës 13.05.2022 me nr 01/400 nga Ministria e Financave Punës dhe Treansfereve ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2023-2025.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „KORNIZA AFATMESME BUXHETORE ( KAB ) E KOMUNËS SË VITISË 2023-2025 “ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

#### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI

Bekim Azizi





Qendra e Kryerëzimit të Komunitetit të Kosovës  
 Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
 Ministria e Punëve të Brendshme dhe Transfereve  
 Ministry of Internal Affairs and Transfers  
 Prishtinë - Pristina - Priština

02mpt  
 996-80/2022  
 13.07.2022

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Radat i Transfera*  
**Ministry of Finance, Labour and Transfers**

HYRESE - ULAZNA - INCOMING  
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
 Ministry of Local Government Administration

Data: 13.07.2022  
 Data: 13.07.2022

Niveli organizativ: Nr. i aktit: Vlera:  
 -VI- 020-573/3

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë  Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal  Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve  Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	KLIT Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vitisë
Lloji i aktit:	<b>Vendim</b>

I nderuari Kryetar z. Haliti,  
 I nderuari Kryesues z. Azizi,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin 01-110/05-660 për kornizën afatmesme buxhetore (KAB) të komunës së Vitisë, 2023-2025
I miratuar më datë 29.06.2022
I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.07.2022
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 01.07.2022

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vitisë, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit, Komuna e Vitisë ka synuar miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2023.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i mësipërm evidentohet në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 (këtej e tutje referuar si "LMFPP").
3. Kështu, neni 20 i LMFPP-së qartëson se Ministri nxjerrë qarkore buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës. Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, më datë 13.05.2022, Ministri ka nxjerrë Qarkoren Buxhetore 2023/01, në të cilën janë ofruar udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2023.
4. Në kuptim të paragrafit 3 të këtij vlerësimi, vendimi i nxjerrë nga Komuna e Vitisë është në përputhje me udhëzimet e dhëna në Qarkoren Buxhetore 2023/01 të datës 13.05.2022, ku më konkretisht precizohet se:

*"Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2023-2025, dhe të aprovojnë në Kuvendin Komunal deri më datë 30.06.2022 si dokument strategjik komunal, i cili bazohet në synime dhe objektiva të orientuara në rezultate, pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve."*

5. Rrjedhimisht dhe si përfundim, Ministria konstaton se **akti i Komunës është në përputhje me legjislacionin në fuqi**, në kuptimin që Komunave iu lejohet nxjerrja e vendimeve lidhur me miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, mirëpo realizimi i suksesshëm i vendimit tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e dokumentit përkatës në raport me udhëzimet e përcaktuara në Qarkoren Buxhetore 2023/01.